
OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQENDRUARA SH.A

Tiranë, më 12.02.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Kompletimi me pajisje informatike dhe teknologjike (TIK) jo sipas standarteve të AKSH-it të dy godinave (fakultet /mensë të Akademisë së Forcave të Armatosura”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP):

Makineri për zyra dhe informatike, pajisje dhe furnizime, përveç mobiljeve dhe paketave software 30000000-9, Pajisje kompjuterike dhe furnizime 30200000-1, Pajisje të ndryshme kompjuterike 30236000-2.

VLERA E FONDIT LIMIT TË KONTRATËS:

Fondi limit: 44,738,443.12 (dyzet e katër milion e shtatëqind e tridhjetë e tetë mijë e katërqind e dyzet e tre pikë dymbëdhjetë) lekë pa tvsh ose 463.851 (katërqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e tetëqind e pesëdhjetë e një) EURO pa tvsh.

*Vlera e mësipërme është konvertuar në monedhën Euro sipas kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë, datë 12.02.2026, me kurs këmbimi 96.45(nëntëdhjetë e gjashtë pikë dyzet e pesë) lekë.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” (të ndryshuar) nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Autoriteti/Enti Kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara në rolin e Organit Qëndror Blerës, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, ndërsa nga ana e grupit të punës të ngritur pranë Autoritetit Kontraktor përfitues Ministria e Mbrojtjes /Akademia e Forcave të Armatosura janë hartuar specifikimet teknike me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kriteret e mesipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe në mbështetje të nenit 26, nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vërtetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 25 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se vlera e fondit limit objekt prokurimi**. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është e mbështetur në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenin 42 pika 3, nenin 43 pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Deklarata

tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Në nenin 42 pika 3 përcaktohet se: “Kur kontratat për punë/mall/shërbim ndahet në lote, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat e veçanta të kualifikimit për secilin lot. **Kërkesat duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e lotit**” dhe nenin 43 pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” te ndryshuar, ku përcaktohet se “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar” duke qënë se vlera e fondit limit të lotit përkatës është mbi vlerën e kufirit të lartë monetar dhe kriteri për secilin lot dhe konkretisht ai i përmbushjes së xhiros hartohet në përputhje me vlerën e vetë lotit dhe jo vlerës totale të procedurës. **Në rastin konkret nga ana e Njesisë së Prokurimit është konsideruar e arsyeshme që vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, nxitjen e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë si edhe të sigurimin e një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë ofertuesit e mundshëm ekonomikë.** Marrë shkas nga fakti që referuar përcaktimit të bërë në nenin 43 pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” te ndryshuar se “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar” AK nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së përlllogaritur të vlerës së lotit në kërkesën për kualifikim por në respektim të parimeve ligjore dhe në përmbushjen e qëllimeve të ligjit të prokurimit si më sipër cituar ka tagrin të kërkojë një vlerë më të ulët se dyfishi i vlerës së përlllogaritur të lotit për përmbushjen e vlerës së xhiros minimale vjetore.

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2022, 2023, 2024) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet se: “Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur

nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit”, si dhe në pikën 5 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se:Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitet sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin deklaratën vjetore së bashku me pasqyrat financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji.”, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, për paraqitjen e bilnaceve, është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më pak se 40 % e vlerës së fondit limit objekt prokurimi**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës ose/ dhe faturat tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar nenit 40 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40% të vlerës së fondit limit. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, si dhe aftësinë e tyre në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i certifikuar me:

a) **Standardin ISO 9001** ose ekuivalente (e përditësuar), për sistemin e menaxhimit të cilësisë, objekt i të cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme) dhe të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt-marrëveshjes.

b) **Standardin ISO 27001** ose ekuivalente (e përditësuar) për sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit, objekt i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme, dhe e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë).

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt- marrëveshjes.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë vendosur në përputhje me nenin 79 “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: 1. “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojnë ofertuesve të paraqesin certifikatat të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. Ky kriter gjen mbështetje gjithashtu në piken 1 të nenit 44 “Kërkesat e cilësisë “të VKM nr.285 date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se: 1. “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe nëmënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”. Sa më sipër, ky kriter shërben për njohjen e kapacitetit të operatorëve ekonomikë ofertues dhe aftësinë e tyre teknike dhe profesionale për të furnizuar artikuj cilësorë dhe që janë prodhuar / vendosur në treg sipas standardit të sipërpërmendur. ISO 9001 përcakton kërkesat për një sistem menaxherial të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të certifikohet nga çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit. (e nevojshme për objektin e prokurimit, të cilin AK kërkon të kryhet me cilësi dhe në kohë). Duke parë objektin e prokurimit, autoriteti kontraktor vlerëson të nevojshme të kërkojë që operatorët ekonomikë ofertues të jenë të pajisur me certifikata të cilësisë në përputhje me objektin e prokurimit, me qëllim që furnizimet të kryhen me cilësi sipas çertifikatës ISO të mësipërme. ISO 27001 është standardi ndërkombëtar më i njohur për sistemet e menaxhimit të sigurisë së informacionit. Ai garanton që operatori ekonomik ka politika, procedura dhe kontrole të dokumentuara për mbrojtjen e të dhënave.Përputhshmëria me objektin e prokurimit: Pajisjet TIK që do të instalohen lidhen me rrjete, sisteme komunikimi dhe pajisje multimediale. Pa një sistem të certifikuar të menaxhimit të sigurisë së informacionit, ekziston rreziku i cenimit të integritetit dhe konfidencialitetit të të

dhënave. Duke qenë se Akademia e Forcave të Armatosura është pjesë e strukturave të mbrojtjes, çdo dobësi në menaxhimin e informacionit mund të ketë pasoja të drejtpërdrejta për sigurinë kombëtare. Kërkesa për ISO 27001 është një garanci që operatori ekonomik është i aftë të trajtojë pajisje dhe sisteme në përputhje me standardet e sigurisë.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastruktura dhe Energji, në bazë të VKM-së nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

- N.S – 13A -Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni.
- N.S – 14 A -Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, pika 1 të Ligjit Nr. 162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar); si dhe mbështetur në Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” i ndryshuar.

Në përputhje me objektin e kontratës, i cili konsiston në furnizimin, montimin fizik, integrimin, konfigurimin dhe vënien në funksion të pajisjeve audio-video, pajisjeve të teknologjisë së informacionit dhe sistemeve të komunikimit, kërkohen kërkesa specifike për licencim profesional dhe kapacitete njerëzore, me qëllim garantimin e realizimit të saktë teknik, funksional dhe brenda afateve të parashikuara të projektit.

Megjithatë ndërhyrjet nuk përfshijnë ndërtim civil apo instalime elektrike strukturore, natyra e kontratës nuk përbën thjesht furnizim mallrash, por një proces të integruar teknik që përfshin montim në tavane dhe mure, vendosje pajisjesh multimediale me përmasa të mëdha, kabllim sinjali dhe rrjeti, konfigurim pajisjesh aktive të komunikimit, si dhe integrim të sistemeve wireless, videokonferencë, audio dhe menaxhim qendror të rrjetit. Këto veprime kërkojnë njohuri të specializuara teknike, standarde sigurie në punë dhe aftësi profesionale të certifikuara.

Kërkesa për licencim në nënkategorinë N.S. 13A kërkohet, pasi projekti përfshin instalimin dhe konfigurimin e sistemeve të komunikimit elektronik dhe të rrjeteve të transmetimit të të dhënave, si sistemet wireless me akses point, platforma menaxhimi, firewall, pajisje videokonferencë, switch matrix dhe pajisje të tjera të ndërlidhura me infrastrukturën e rrjetit. Këto elementë përbëjnë sisteme telekomunikacioni dhe IT, të cilat kërkojnë operator ekonomik të licencuar për instalim dhe integrim profesional sipas standardeve teknike përkatëse.

Gjithashtu, kërkesa për licencën N.S. 14A kërkohet për shkak se montimi i pajisjeve elektronike dhe multimediale brenda ambienteve përfshin ndërhyrje teknike të brendshme, vendosje dhe fiksime pajisjesh në tavane e mure, menaxhim kabllimesh dhe lidhje të sigurt me burimet ekzistuese të energjisë, duke kërkuar personel me kompetenca për punë në ambiente të brendshme dhe për

trajtimin korrekt të pajisjeve elektrike dhe elektronike me tension të ulët. Kjo garanton që ndërhyrjet të kryhen në mënyrë të sigurt, pa dëmtime dhe në përputhje me normat teknike.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog/skedë teknike/broshurë për artikujt objekt prokurimi, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme, në mënyrë që të provohet pajtueshmëria me specifikimet teknike sipas dokumenteve të tenderit.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe pikën 6/b, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Kërkesa për paraqitjen e katalogëve/skedës teknike/broshurë nga prodhuesi është një kërkesë e domosdoshme pasi i jep mundësinë Autoritetit kontraktor si Organ Qendror Blerës verifikimin e përputhshmërisë së specifikimeve teknike të artikujve të ofertuar nga operatorët ekonomikë me specifikimet teknike të kërkuara.

Kërkesa për katalogun /skedën teknike/broshurën ka disa avantazhe pais siguron besueshmëri të informacionit. Një dokument teknik garanton që informacioni të jetë i saktë dhe i përditësuar. Përputhshmëria me specifikimet teknike siguron që produktet e ofruara përputhen me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentet e prokurimit. Në kete formë reduktohet rreziku i mashtrimeve ose i ofrimit të produkteve të falsifikuara.

Për sa më sipër, përmes përmbushjes së kësaj kërkesë, AK krijon siguri dhe garanci se mallrat me të cilët do të furnizohet janë sipas specifikimeve të përcaktuara në DST. Ky katalog do të shërbejë gjithashtu edhe në procesin e marrjes në dorëzim të mallrave objekt prokurimi nga Autoriteti Kontraktor përfitues për të kryer krahasueshmërinë e specifikimeve teknike gjatë marrjes në dorëzim të tij.

2.3.5 Për të garantuar ekzekutimin me sukses të kontratës, për të realizuar instalimet dhe konfigurimet e pajisjeve objekt prokurimi operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar stafin teknik si më poshtë vijon:

- a. Të paktën 2 (dy) inxhinierë të diplomuar në Shkenca Elektronike/Teknologji Informacioni/Informatikë/Informatikë Ekonomike/Mekatronike/Telekomunikacion.
- b. Të paktën 2 (dy) punonjës të pajisur me certifikatë mbi sigurimin Teknik
- c. Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për CCNA/ekuivalent
- d. Të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar për instalim, konfigurim të pajisjeve, sistemeve elektronike/IT/audio-video.
- e. Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për menaxhim projektesh PMP/ekuivalent.

***Shënim:** Një punonjës mund të ketë më shumë se një certifikim

Operatori ekonomik në lidhje me stafin teknik të kërkuar më sipër duhet të paraqesë dokumentacionin provues si më poshtë vijon:

Për inxhinieret e diplomuar në Shkenca Elektronike/ Teknologji Informacioni/ Informatikë/Informatikë Ekonomike/Mekatronike/Telekomunikacion

- Kontratë pune të vlefshme;
- Diplomë
- Listpagesat e shoqërisë minimumi muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave

Për stafin teknik të certifikuar

- Kontratë pune të vlefshme
- Certifikatë/Diplomë/Dëshmi kualifikimi lëshuar nga kompania prodhuese e pajisjeve /distributorë të autorizuar nga prodhuesi ose certifikime ekuivalente, lëshuar nga autoritete të autorizuar/certifikuara për dhënien e tyre, me qëllim kryerjen e instalimit konfigurimit të pajisjeve, sistemeve elektronike/IT/audio-video të cilat janë objekt prokurimi.

Shenim: Kriteri i përcaktuar në pikën 2.3.5 konsiderohet i permbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohej sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të nenit të 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, pika 5/b/c, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar; Ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kriteret e kualifikimit janë vendosur për të garantuar ekzekutimin me sukses të kontratës, duke marrë në konsideratë kompleksitetin teknik të artikujve të përfshirë në preventiv, afatin e realizimit prej 30 (tridhjetë) ditësh, si dhe nevojën për siguri teknike dhe funksionale gjatë procesit të instalimit dhe konfigurimit të pajisjeve.

Instalimi profesional i pajisjeve garanton respektimin e standardeve të sigurisë elektrike, funksionimin korrekt të sistemeve dhe shmangien e defekteve teknike apo aksidenteve gjatë montimit dhe vënies në funksionim.

Duke qenë se sasia e artikujve objekt prokurimi është e konsiderueshme, si p.sh. 30 mbajtëse/projektorë, 30 tabela interaktive, 16 whiteboard, si dhe pajisje të tjera audiovizive dhe teknologjike, kërkohej staf i specializuar dhe i kualifikuar, i aftë të përballojë volumnin e punës dhe kompleksitetin e instalimeve brenda afatit të përcaktuar në kontratë.

1. Rëndësia e realizimit të instalimit dhe konfigurimit brenda afatit 30-ditor

Kontrata parashikon që lëvrimi, instalimi dhe konfigurimi i pajisjeve të realizohet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e lidhjes së kontratës, afat i cili kërkon:

- planifikim dhe organizim të saktë teknik;
- ndërhyrje të njëkohshme në disa ambiente;

- disponueshmëri të menjëhershme të stafit të kualifikuar.

Mosrespektimi i këtij afati do të ndikonte drejtpërdrejt në funksionimin normal të institucionit përfitues dhe në realizimin e qëllimit të investimit publik. Për këtë arsye, kërkohet që operatori ekonomik të provojë paraprakisht se disponon kapacitet real njerëzor dhe profesional për realizimin e kontratës brenda afatit.

Operatori ekonomik të disponojë të paktën 2 (dy) punonjës të diplomuar, në Shkenca Elektronike, Teknologji Informacioni, Informatikë, Informatikë Ekonomike, Mekatronikë ose Telekomunikacion, është vendosur për të garantuar kapacitetin minimal dhe të nevojshëm profesional për realizimin korrekt të kontratës.

Punonjësi(i) i diplomuar siguron:

- koordinimin dhe mbikëqyrjen teknike të procesit të instalimit dhe konfigurimit.
- interpretimin e dokumentacionit teknik dhe specifikimeve të prodhuesve.
- zgjidhjen e problematikave teknike gjatë vënies në funksionim.
- respektimin e standardeve teknike dhe funksionale.

Prania e këtij kapaciteti profesional përfaqëson garancinë minimale që operatori ekonomik është teknikisht i aftë për të menaxhuar dhe realizuar kontratën.

Inxhinierët e teknologjisë së informacionit konsiderohen të domosdoshëm për shkak të nevojës për projektim logjik të rrjetit, konfigurim të pajisjeve aktive, menaxhim sigurie, integrim të platformave dhe testim funksional të sistemeve të komunikimit.

Po ashtu, **kërkesa për personel të certifikuar në rrjete (CCNA ose ekuivalent)** siguron që konfigurimet të realizohen sipas praktikave profesionale dhe standardeve ndërkombëtare, duke garantuar stabilitet, siguri dhe performancë të qëndrueshme të infrastrukturës.

Përfshirja e teknikëve të certifikuar për instalim dhe konfigurim të pajisjeve elektronike, IT dhe audio-video lidhet drejtpërdrejt me natyrën praktike të punimeve, të cilat përfshijnë montim fizik, kalibrim, testim dhe integrim të pajisjeve si tabela interaktive, sisteme audio, videokonference, projektorë, ekrane dhe pajisje të tjera multimediale. Këto sisteme kërkojnë ekspertizë specifike për funksionim të plotë dhe pa defekte. Nevoja për staf të certifikuar për instalim dhe konfigurim të pajisjeve. sistemeve elektronike/IT/audio-video.

Përveç instalimit fizik, kontrata përfshin konfigurim teknik, parametrizim dhe integrim funksional të pajisjeve të mëposhtme:

- Switch Matrix
- Sistem Audio
- Tabela Interaktive 110''
- Sistem Portabel Përkthimi
- Sistem Wireless (16 Access Point + Platformë Menaxhimi / Firewall)

Këto pajisje kërkojnë:

- konfigurim hardware dhe software sipas specifikimeve të prodhuesit.
- integrim në rrjet.
- testim funksional dhe vënie në punë.

Për këtë arsye, kërkohet që operatori ekonomik të disponojë të paktën 2 (dy) punonjës të çertifikuar për instalim dhe konfigurim të pajisjeve, sistemeve elektronike/IT/audio-video., në mënyrë që të garantohet funksionim korrekt, shmangie e keqfunksionimeve dhe përdorim i plotë i pajisjeve nga institucioni përfitues.

Personeli i trajnuar në sigurinë teknike në punë është i nevojshme për shkak të punimeve në lartësi, montimeve në tavane dhe mure, si dhe manipulimit të pajisjeve me peshë dhe dimensione të konsiderueshme, me qëllim garantimin e mbrojtjes së punonjësve dhe të ambienteve ku kryhen ndërhyrjet.

Kërkesa për një person të certifikuar në menaxhim projektesh konsiderohet e arsyeshme duke marrë parasysh volumin e pajisjeve, numrin e sistemeve që duhet të instalohen paralelisht dhe afatin e kufizuar të zbatimit 30 ditor. Koordinimi profesional i fazave të furnizimit, montimit, konfigurimit dhe testimit është thelbësor për respektimin e afateve kontraktore dhe për garantimin e dorëzimit funksional të projektit.

Në përfundim, kriteret e përcaktuara për licencim dhe personel përfaqësojnë kërkesa proporcionale dhe teknikisht të justifikuara, të cilat synojnë sigurimin e cilësisë, sigurisë dhe funksionalitetit të plotë të sistemeve të instaluar, si dhe realizimin korrekt dhe në kohë të kontratës, në përputhje me standardet profesionale.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për përmbushjen e afatit të garancisë për pajisjet objekt prokurimi konform përcaktimit të bërë në specifikimet teknike duke nisur nga data e instalimit dhe vendosjes në funksion të plotë të tyre dhe gjatë së cilës ofertuesi do të sigurojë riparimin e defekteve që vijnë për shkak të prodhimit dhe instalimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" të ndryshuar dhe nenin 40 pika 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, autoriteti kontraktor kërkon të sigurohet se, operatori ekonomik do të garantojë se artikujt e ofruar janë cilësorë dhe sipas standarteve të kërkuara në dokumentet e tenderit. Në cdo rast operatori ekonomik gjatë periudhës së garancisë duhet të mbajë përgjegjësi për mallat që ofron dhe se do t'i përgjigjet autoritetit kontraktor në rast se malli i furnizuar dëmtohet gjatë përdorimit për shkak të difekteve që vijnë si rrjedhojë e prodhimit apo instalimit të tyre.

2.3.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë **një deklaratë** me anë të së cilës merr përsipër të kryejë **shërbimin e transportit** të mallit në adresën e përcaktuar nga autoriteti kontraktor.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar dhe nenin 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri

kërkohej që operatorët të sigurojnë autoritetin kontraktor se transporti i mallit do të realizohet në kohë dhe në vendin e caktuar nga Autoriteti Kontraktor përfitues.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për s'kualifikim.

Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike :

*Përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike është grupi i punës i ngritur pranë Autoritetit Kontraktor përfitues Spitali Rajonal Shkodër për objektin që prokurohet, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”. Specifikimet teknike janë si më poshtë vijon;*

1. INFORMACION MBI INFRASTRUKTURËN AKTUALE (TIK)

Nr. i kompjuterave: Aktualisht, në Akademinë e Forcave të Armatosura (AFA) janë funksionale 3 klasa informatike, të pajisura me laptopë të avancuar dhe kompjuterë desktop. Numri total i pajisjeve është mbi **90 kompjutera**, të gjithë të lidhur në rrjet dhe të aksesueshëm nga studentët e cikleve Bachelor dhe Master. Me ndërtimin e kampusit të ri të AFA-së, synohet të shtohen edhe 5 klasa të tjera informatike, duke e çuar numrin total të pajisjeve informatike në një kapacitet që mbështet **mbi 190 përdorues**. Kjo rritje reflekton zgjerimin e kapacitetit akademik të AFA-së dhe rritjen e ofertës akademike për programet Bachelor dhe Master.

Sistemet e operimit: Të gjitha kompjuterët, si laptopët e avancuar ashtu edhe desktopët, operojnë me sistemin operativ **Windows 11**, i cili ofron një platformë të sigurt, të qëndrueshme dhe të përshtatshme për nevojat akademike dhe profesionale të përdoruesve.

Përveç kompjuterëve, infrastruktura TIK në AFA përfshin:

- Projektorë, të instaluar në të gjitha klasat për mbështetje të prezantimeve dhe leksioneve interaktive.
- Tabela shënimi, të përdorura nga pedagogët për ilustrime dhe shënime gjatë orëve mësimore.
- Printera, fotokopje të cilët janë në dispozicion të stafit dhe studentëve për të mbështetur printimin e materialeve mësimore dhe dokumenteve të tjera akademike.

Pajisjet dhe infrastruktura aktuale janë në funksion të procesit të mësimdhënies dhe të kërkesave të studimit të studentëve, duke siguruar qasje të lirë dhe të plotë për të gjithë përdoruesit e cikleve Bachelor dhe Master. Me rritjen e kapaciteteve infrastrukturore në kampusin e ri, synohet përmirësimi i mëtejshëm i kushteve të mësimdhënies dhe teknologjisë së përdorur.

2. QËLLIMI

Kompletimi/pajisja e AFA me pajisjet bashkëkohore, do të ndikojë dukshëm në rritjen e performancës së këtij institucioni si dhe vetë Forcave të Armatosura. Akademia e Forcave të Armatosur po transferohet në godine të re bashkëkohore e cila plotëson kushtet moderne për zhvillimin e programeve mësimore në të gjitha nivelet e studimit dhe jo vetëm si dhe kurset përgatitore të oficerit.

Akademia e Forcave të Armatosura ka potencialin për t'u bërë pjesë në zhvillimet që po ndodhin në këtë fushë duke kontribuar si në përgatitjen e brezit të ri (studentët / kadetët e akademisë) dhe në ngushtimin e hendekut midis shkollimit dhe tregut të punës.

Furnizimi me pajisjet e kërkuara si pjesë e laboratorëve / kabineteve që do të ngrejë AFA, ndër të tjera kanë këto përfitime për AFA-në dhe studentët:

1. **Trajnimi me teknologji të avancuar:** Laboratori do të ofrojë pajisje që përmbushin standardet e industrisë, duke mundësuar trajnime të avancuara në fushën e sigurisë dhe rrjetave.
2. **Sigurimi i një ambienti të sigurt dhe efektiv për mësim:** Me teknologjinë e fundit në menaxhimin dhe mbrojtjen e rrjetave, laboratori do të sigurojë një mjedis të përshtatshëm për simulime praktike dhe studime të avancuara.

3. OBJEKTI

Akademia e Forcave të Armatosura, si institucioni i vetëm i arsimit të lartë në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes dhe si njësi mbështetëse në strukturën e Forcave të Armatosura ka detyrën dhe përgjegjësinë të përgjigjet lidhshëm ushtarak dhe civil me produkte shkencore, inovative si dhe të mbështesë Shtabin e Përgjithshëm, Komandat e Forcave dhe njësitë e vartësisë së MM me doktrina, manuale dhe rregullore sipas një plani vjetor të kaluar në bordin e botimeve dhe të miratuar me urdhër nga MM. Ambientet ku do të zhvillohet mësim, të cilat do të pajisjet me produktet sipas këtij projekti, do të jenë të kompletura me pajisje Informatike dhe Teknologjike bashkëkohore sipas standarteve më të larta duke filluar nga laboratorët e IT, klasat e zakonshme, sallat e leksioneve, auditorium, biblioteka, zyrat e stafit akademik dhe administrativ, menca e studentve, dhe cdo ambient i nevojshëm në funksion të procesit akademik dhe jetës studentore.

Objektivat që kërkohen të arrihen nga institucioni përfitues përmes këtij investimi janë si më poshtë:

- Vendosja në efikasitet dhe bazë didaktike për zhvillimin e procesit mësimor në Akademinë e Forcave të Armatosura, e cila ka ardhur si shkak i zhvillimit të vrullshëm të

teknologjisë, kërkesës së vazhdueshme nga niveli i lartë i kërkesave për zhvillimin e inovacionit në fusha të ndryshme.

- Pajisja e laboratorëve IT me videoprojektor, smartboard TV interaktiv, whiteborad, gjithashtu përditësim i auditorëve sipas standarteve moderne në përputhje me kurrikulën e ofruar në fushën e IT në nivelin Bachelor dhe Master.
